



# TË MËSOJMË MË SHUMË PËR VETEN DHE PROFESIONET

Material për nxënësit e klasave **3-5**






Ky material është në mbështetje të edukimit dhe këshillimit për karrierën për nxënësit në arsimin parauniversitar dhe ofrohet për shkollat e përzgjedhura në Tiranë për pilotim në vitin shkollor 2022-2023 sipas marrëveshjes ndërmjet **Ministrit të Arsimit dhe Sportit** dhe **Bashkisë së Tiranës**, lidhur më datë **05.05.2022**. Materiali është menduar për përdorim në orët e kujdestarisë nga mësuesit kujdestarë, psikologët, punonjësit socialë në shkolla ose punonjësit e këshillimit të karrierës në Bashkinë e Tiranës.

Këto veprimtari janë pjesë e një programi më të gjerë për zhvillimin e edukimit dhe këshillimit të karrierës në Shqipëri dhe mbështeten nga:

Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Materialet u përgatitën nga

**Astrit Dautaj**, Përgjegjësi i Kurrikulës në ASCAP  
**Sokol Avxhiu**, Ekspert/Këshillues për Karrierën


## Hyrje

Moduli **“Të mësojmë më shumë për veten dhe profesionet”** për nxënësit e arsimit fillor (kryesisht me fëmijët e klasës së tretë, të katërt dhe të pestë) synon të përfshijë nxënësit e kësaj moshe në një proces reflektimi për vlerën e punës për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve që plotësojnë nevojat dhe dëshirat e njerëzve dhe të fëmijëve në mënyrë të veçantë.

Nxënësit ftohen të lidhin profesionet me llojet e punëve që plotësojnë nevojat dhe dëshirat e tyre; të mësojnë për rëndësinë e vlerën e çdo pune e profesioni dhe t'i respektojnë ato.

Po kështu, ata ftohen të identifikojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punët dhe shërbimet, me të cilat lidhen profesionet e ndryshme, orientohen të fillojnë të mendojnë për dëshirat e tyre për të ardhmen, për rëndësinë që ka shkolla për pajisjen e tyre me njohuritë dhe aftësitë, që kërkojnë profesionet që ata dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen.

Nxënësit nxiten të mendojnë për rëndësinë e të mësuarit të vazhdueshëm dhe në të gjitha lëndët, për të qenë të aftë të zgjedhin profesionin që dëshirojnë, kurdo qoftë koha për të marrë këto vendime.





## Si dhe ku duhet të zhvillohet moduli?

Moduli përmban disa veprimtari të lidhura në mënyrë logjike me njëra-tjetrën, duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe pavarësinë e tyre.

Moduli është menduar të zhvillohet në 6 orë mësimore. Megjithatë, ai mund të shtrihet edhe më gjatë, në varësi të kërkesave ose të veçorive të mjedisit shkollor.

Në varësi të hapësirave që krijohen në kohë të ndryshme, mund të zhvillohen edhe veprimtaritë që janë pjesë e tyre, nëse një nevojë e tillë lind gjatë kryerjes së veprimtarive mësimore, të veprimtarive jashtëkurrikulare ose jashtëshkollore.

Moduli është menduar të zhvillohet nga **psikologu i shkollës**, roli i të cilit në këtë rast merr edhe një dimension të ri.

Moduli mund të zhvillohet edhe nga **mësuesi kujdestar** në kuadrin e orëve të kujdestarisë.

Po kështu, veprimtari të veçanta të tij mund të zhvillohen edhe nga **mësues të lëndëve të ndryshme**, kur përmbajtja mësimore e mundëson këtë trajtim. Mundësi të tilla ekzistojnë në lëndën e qytetarisë, por edhe në lëndë të tjera, pasi secila prej tyre lidhet, përmes përmbajtjes, me realitetin, me mjediset e punës, me nevojat e dëshirat e nxënësve etj.

Moduli i plotë ose veprimtari të veçanta të tij mund të zhvillohen në mjedise të ndryshme mësimore ose në shkollat qendra komunitare, nga të ftuar të tillë, si: **sipërmarrës, prindër ose punonjës të bashkive**, të cilët gjithnjë e më shumë po shtojnë në misionin e tyre, edhe informimin e publikut për botën e punës dhe të mundësive të saj.

Veprimtaritë e veçanta janë parashikuar të zhvillohen brenda 45 minutave, gjatë të cilave drejtuesi dialogon me nxënësit. Ai i fton ata në një proces reflektimi të pavarur individual, rezultatet e të cilit nxënësit i fiksojnë në fletët e tyre të punës. Është mirë që drejtuesi i veprimtarive (p.sh.: psikologu, mësuesi etj.) të ketë fotokopjuar fletët e punës për të gjithë nxënësit.

Me lejen e nxënësve, fletët e plotësuara mund të vendosen në një vend të dukshëm në klasë dhe në vijim, idetë e shprehura në to mund të bëhen objekt diskutimi në klasë. Që në fillim, mësuesi u bën të qartë nxënësve se ata do të ndajnë idetë dhe reflektimet e tyre me njëri-tjetrin.

Në fund të veprimtarisë, organizuesi i saj bën **përmbledhjen** e ideve kryesore të modulit dhe të atyre të shprehura nga nxënësit. Në këtë përmbledhje, ai mban parasysh objektivat e veprimtarisë dhe kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të saj - **edukimin për karrierën**.

**Të mos harrojmë!** Veprimtaritë e kësaj faze nuk synojnë të ndihmojnë nxënësit të zgjedhin karrierën që në shkollën fillore, por t'i ndihmojnë ata të kuptojnë ndërlidhjen e gjithë çka bëjmë në jetë. Në këtë kuadër, dëshirat tona për të ardhmen na shtyjnë ose na **motivojnë** të zgjedhim të bëjmë disa gjëra sot, ndërkohë që ajo që bëjmë sot, ndikon shumë në krijimin e **mundësive** tona për të ardhmen. Që në këtë moshë, fëmijët fillojnë të hedhin hapat e parë drejt krijimit të një modeli të vendimmarrjes.





# 1. Nevojat dhe dëshirat e mia

## Fokus



Plotësimi i nevojave dhe i dëshirave të njeriut është baza për të jetuar me dinjitet dhe për të përcaktuar llojet e punëve e të profesioneve që janë të nevojshme për prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve, të domosdoshme për plotësimin e nevojave dhe dëshirave.

Njohja e nevojave dhe e dëshirave është e rëndësishme jo vetëm për të kuptuar lidhjen e tyre me dinjitetin njerëzor dhe me të drejtat e njeriut, por edhe me punët e profesionet që mundësojnë plotësimin e tyre.

## Objektivat



*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të identifikojë disa nga nevojat dhe dëshirat e tij.
- të lidhë nevojat dhe dëshirat me të drejtën për të jetuar me dinjitet dhe për t'u zhvilluar.
- të tregojë nevojat dhe dëshirat që duhet të plotësojë për të jetuar më mirë.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.



## Cilat janë nevojat dhe dëshirat e mia?



a. Për të jetuar, unë kam nevojë:

- të ushqehem,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_,
- të jem i sigurt.

b. Për t'u zhvilluar, unë kam dëshirë:

- të mësoj,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_,

c. Për të jetuar më mirë, unë kam nevojë dhe dëshirë:

- të kem një mjedis të pastër,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_,
- të \_\_\_\_\_.





## 2. Nga nevojat dhe dëshirat te profesionet

### Fokus



Profesionet nuk janë të rastësishme. Ato nuk janë krijime të mendjeve krijuese, pa të cilat ato nuk do të ekzistonin. Profesionet janë rezultat i veprimtarive prodhuese ose shërbimeve të nevojshme për të plotësuar nevojat e njerëzve për të jetuar dhe dëshirat që ata kanë, për zhvillimin e tyre tërësor, fizik, intelektual e shpirtëror.

### Objektivat



*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të lidhë nevojat dhe dëshirat me llojet e punëve dhe të profesioneve, që janë krijuar për plotësimin e tyre.
- të identifikojë llojin e punës ose të profesionit që lidhet me disa veprimtari ose produkte, të cilat prodhohen për të plotësuar nevojat dhe dëshirat.
- të eksplorojë disa nga llojet e profesioneve që duhet të lidhen së bashku për të prodhuar një produkt.
- të eksplorojë grupet e aftësive që duhet të zotërojë një person, i cili kryen një varg punësh, për të plotësuar një nevojë ose dëshirë.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.





a. Për të plotësuar nevojat dhe dëshirat, janë krijuar shumë profesione.

**Hulumtoni:**

- Bukën e prodhon bukëpjekësi,
- Shtëpinë e ndërton \_\_\_\_\_
- Rrobat i qep \_\_\_\_\_
- Në shkollë punojnë \_\_\_\_\_
- Lodrat i bën \_\_\_\_\_
- Mjedisin e mban pastër \_\_\_\_\_
- Për rrugët kujdeset \_\_\_\_\_
- Për shëndetin tonë kujdesen \_\_\_\_\_

b. Për të plotësuar një nevojë ose një dëshirë, nuk mjafton një profesion i vetëm. Profesione lidhen me njëri-tjetrin.

**Hulumtoni:**

Cilat profesione bëjnë të mundur që unë të kem bukën në shtëpi?

- Profesion i \_\_\_\_\_ lidhet me prodhimin e drithërave, me të cilat bëhet buka.
- Profesion i \_\_\_\_\_ lidhet me pjekjen e bukës.
- Profesion i \_\_\_\_\_ më jep mua mundësinë ta blej bukën.

c. Dikush mund të vendosë t'i bëjë të gjitha vetë. Kjo do të thotë se ai duhet të ketë njohuritë dhe aftësitë, që kërkohen nga të gjitha këto profesione të veçanta.

**Hulumtoni:**

Dy profesione që kërkojnë njohuri nga shumë fusha:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_

Njohuritë që kërkohen nga këto profesione, janë të fushës së:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_



d. Shumë profesione janë krijuar për të ndihmuar të tjerët.

1. Një ditë unë pata nevojë për ndihmë. Mua më ndihmoi:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

2. Atë ditë unë ndjeva:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

3. Nëse do të kisha një profesion që ndihmon të tjerët, unë do të zgjidhja profesionin e ... sepse:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_



### 3. Sot në qytetin tim mungon një profesion Si t'ia bëjmë?

#### Fokus



Nxënësit ftohen të thellohen në idenë që profesionet janë krijuar për të plotësuar nevojat dhe dëshirat. Ata ftohen të fillojnë të projektojnë veten edhe si pjesë e zgjidhjes së problemeve që, në këtë rast, ka të bëjë me nderimin dhe respektimin e çdo profesioni të rëndësishëm për nevojat e komunitetit.

#### Objektivat



*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të tregojë rëndësinë që kanë llojet e punëve dhe të profesioneve për jetën e komunitetit dhe respektin për çdo profesion dhe njeriun e punës.
- të parashikojë pasojat e mungesës së një profesioni që lidhen me plotësimin e një nevoje ose shërbimi të rëndësishëm për njerëzit ose për komunitetin.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.





Një ditë në qytetin tim mungoi profesioni i ...

Large dashed-line writing area for the first question.

Si rrjedhë ...

Large dashed-line writing area for the second question.



## TË MËSOJMË PËR TË ARDHMEN TONË

Të gjitha profesionet janë të rëndësishme, sepse ...

Blank writing area with horizontal dashed lines for text.

Ne duhet të nderojmë çdo profesion dhe të jemi të gatshëm për të kryer çdo punë, sepse ...

Blank writing area with horizontal dashed lines for text.



## 4. Çfarë më pëlqen të bëj sot?

### Fokus



Kur fëmijët pyeten për punën dhe profesionin që dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen, ata zgjedhin punët ose profesionet që i dëshirojnë, pavarësisht se cilat janë mundësitë për t'i realizuar ëndrrat e tyre. Ata nuk marrin parasysh profesionet që prindërit e tyre dëshirojnë për ta dhe, as i lidhin këto profesione me sasinë e të ardhurave. Fëmijët, thjesht, janë të sinqertë në këto dëshira dhe i lidhin profesionet e tyre me to.

Sigurisht, këto do të ndryshojnë, ndërkohë që ata ndeshen me idenë e fitimit, me përparësitë dhe ambiciet e prindërve etj.

Është mirë që kjo dëshirë e tyre e parë të shfrytëzohet për të mbajtur gjallë motivet e tyre të shëndosha dhe ndikimin e tyre për të motivuar të mësuarit.



### Objektivat

*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të reflektojë dhe të ndajë me të tjerët pëlqimet vetjake.
- të reflektojë dhe të tregojë për gjërat që pëlqen të bëjë në shtëpi.
- të reflektojë dhe të tregojë për disa nga dëshirat e tij.
- të reflektojë për gjërat që mendon se duhet të përmirësojë te vetja.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.





Tri gjëra që më pëlqen të bëj, janë:

Handwriting practice area with five horizontal dashed lines for writing.

Gjërat që më pëlqejnë të bëj në shtëpi, janë:

Handwriting practice area with five horizontal dashed lines for writing.

Nëse do të shkoja diku, do të më pëlqente të shkoja në ....., sepse .....

Handwriting practice area with five horizontal dashed lines for writing.





## TË MËSOJMË PËR TË ARDHMEN TONË

Nëse do të isha artist, atëherë do të më pëlqente të isha ...

Blank writing area with horizontal dashed lines for the first question.

Lëndët që më pëlqejnë më shumë, janë:

Blank writing area with horizontal dashed lines for the second question.

Tri gjëra që dëshiroj të përmirësoj te vetja, janë:

Blank writing area with horizontal dashed lines for the third question.



## 5. Unë dhe profesionet

### Profesionet duhet t'i njohim më mirë

#### Fokus



Njohuritë që fëmijët kanë për profesionet, janë të cinguara dhe shpesh të pasakta. Fëmijët, si në çdo vendimmarrje tjetër, duhet të dinë më shumë për profesionet që dëshirojnë për të ardhmen e tyre. Ata duhet të kuptojnë rëndësinë e të qenit të mirinformuar për gjërat që do të marrin vendim dhe të mësojnë të kërkojnë për të mësuar më shumë për to.

#### Objektivat



*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të flasë për profesionet që dëshiron për të ardhmen.
- të shpjegojë pse dëshiron të punojë në këto profesione.
- të kërkojë informacion për profesionet që dëshiron për të ardhmen.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.



## FLETA E PUNËS SË NXËNËSIT NR. 5



Profesioni ose profesionet që dëshiroj të bëj kur të rritem:

-----

-----

Arsyet pse dëshiroj të punoj në këtë ose këto profesione, janë:

-----

-----

Unë dëshiroj të mësoj më shumë për profesionin e ...

-----

-----

Për të marrë informacion për këto profesione, unë mendoj t'i drejtohem ...

-----

-----

Unë do të përpiqem të gjej edhe të tjerë, që të më japin më shumë informacion.  
Cilët mund të jenë ata?

-----

-----



## 6. Profesionet dhe unë

### Profesionet kërkojnë njerëz të aftë

#### Fokus



Në këtë veprimtari, fëmijët fillojnë të eksplorojnë aftësitë që kërkohen në punët dhe profesionet që dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen. Po kështu, ata fillojnë të reflektojnë për njohuritë dhe aftësitë e tyre, që ata mendojnë se lidhen me këto profesione.

Në këtë mënyrë, fëmijët thellohen në procesin e njohjes së vetes, në vlerat që kanë dhe fillojnë ta shohin veten edhe në këndvështrimin e mangësive. Në këtë drejtim, psikologu/mësuesi duhet të bëjë kujdes që nxënësi t'i shohë mangësitë në aspektin e punës që duhet të bëjë për të realizuar këto dëshira dhe jo si pengesa të pakapërcyeshme në rrugën e realizimit të tyre.

#### Objektivat



*Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:*

- të lidhë profesionet që dëshiron me aftësitë që ato kërkojnë.
- të tregojë lëndët që zhvillojnë aftësitë për profesionet që ëndërron.
- të reflektojë për aftësitë që zotëron.
- të reflektojë për drejtimet, në të cilat mendon të përmirësohet.

**Materiale:** Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



**Kohëzgjatja:** 45 minuta.



**Eksploroni:**

► Aftësitë që kërkohen për profesionet që ëndërroj:

- Njohuri në lëndën e matematikës,
- Njohuri në lëndën e diturisë,
- Njohuri në lëndën e \_\_\_\_\_,
- Njohuri në lëndën e \_\_\_\_\_,
- Njohuri artistike,
- Punë me kafshë,
- Aftësi kompjuterike,
- Aftësi për të punuar vetëm e në mënyrë të pavarur,
- Aftësia për të qenë krijues,
- \_\_\_\_\_,
- \_\_\_\_\_,
- \_\_\_\_\_.



## TË MËSOJMË PËR TË ARDHMEN TONË

► Cilat lëndë në shkollë i formojnë këto aftësi?

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

► Unë mendoj se do të jem i mirë në këtë profesion, sepse:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

► Unë mendoj se duhet të përmirësohem në:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_







## BASHKIA TIRANË ZYRA E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS

Zyra e këshillimit të karrierës së bashkisë ofron informacione për profesionet, tregun e punës, ofertën arsimore, mundësitë e trajnimit, si dhe zotëron mjetet për shërbimin e këshillimit të karrierës.

Vizitoni faqen zyrtare me poshtë për të gjetur informacionin dhe shërbimin që ju nevojitet!

**[www.karriera.tirana.al](http://www.karriera.tirana.al)**

Zyra është e hapur çdo ditë, nga e hëna në të premten, 08:00 - 16:00.

**Email:** karriera@tirana.al

**Tel:** 0800 0888

**Adresa:** Rruga e Elbasanit, Parku “7 xhuxhat”, Tiranë

## **AKPA** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Në tërësinë e shërbimeve të AKPA-s përfshihen shërbimet e punësimit dhe administrimi i sistemit publik të arsimit dhe formimit profesional. Agjencia mbledh informacion edhe për ofruesit privat të formimit dhe është përgjegjëse për licencimin e tyre. Agjencia është e pranishme në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet zyrave vendore të punësimit, drejtorive rajonale të formimit profesional publik dhe shkollave të arsimit profesional publik.

Portali Kombëtar i Punësimit është platforma, në të cilën ju mund të gjeni informacione për kualifikime profesionale, për vende të lira pune dhe hapësira ku mund të krijoni profilin tuaj si punëkërkes.

**[www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al)**

Zyrat e Punës së Shqipërisë

**Tel:** +35544538827

**Email:** kontakt@akpa.gov.al

Hënë - Enjte: 08:00-16:30 / Premte: 08:00-14:00